

**Dr. Frashër DEMAJ**

**KONTRIBUT I ÇMUAR NË STUDIMIN E MARRËDHËNIEVE  
SHQIPTARO-HEBRAIKE**

**Haxhi Bajraktari, “Marrëdhëniet Shqiptaro Hebraike”, botoi  
Instituti i Studimeve Politike-Tiranë, fq. 230, Prishtinë, 2009.**

Libri “Marrëdhëniet shqiptaro- hebraike” i autorit Haxhi Bajraktari është ndër të rrallët në këtë fushë studimi dhe padyshim paraqet një kontribut të rëndësishëm në trajtimin e marrëdhënieve dymijë vjeçare dhe kontakteve në mes këtyre dy popujve

Autori i librit ofron fakte për lidhjen, marrëdhëniet e shkëlqyera dhe ndihmën reciproke të këtyre dy popujve që nga lashtësia e deri në kohërat moderne.

Kronologjia e kësaj bashkekzistence nis me kontaktet e para të ilirëve me hebrenjtë romanistë në kohën e Perandorisë Romake. Për këtë kohë të largët autori ofron argumente të bazuara në burime materiale dhe të shkruara. Ndër burimet më të shpeshta materiale për kohën e vjetër dhe mesjetën përmenden sinagogat e gjetura në shume vende të Shqipërisë së sotme. Autori është mbështetur edhe në burimet e kronistëve të cilët kanë udhëtuar nëpër tokat shqiptare, posaçërisht në viset bregdetare. Vendosja përkatësisht ardhja e hebrenjve ndodh në periudhën e pushtimit të gjatë të Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Autori saktëson dy valë të mëdha të ardhjes së hebrenjve në tokat shqiptare, në shekullin XVI, duke përcaktuar ardhjen e tri grupeve hebrenjsh: grupi i cili kishte një lidhje të hershme me shqiptarët, pra ai i romanistëve, seferadikët e ikur nga Gadishulli Iberik, dhe grupi i ardhur nga Italia të njohur si pugliesë.

Edhe në shekullin XVII autori merret me bashkësinë hebraike si një komunitet tejet aktiv sidomos në kohën dhe territoret e qeverisura nga Ali Pashë Tepelena. Autori jep të dhëna të hollësishme për popullsinë hebraike në qytetet shqiptare edhe gjatë shekullit XIX dhe XX duke përfshirë këtu edhe qytetet kryesore të Kosovës. Nga Lufta e Parë Ballkanike e deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore autori me sukses argumenton, sqaron dhe fakton rrethanat e krijuara në Ballkan, shpalljen e pavarësisë së shtetit shqiptar, mbetjen e më shumë se gjysmës së popullsisë shqiptare jashtë shtetit, praninë e hebrenjve, gjendjen e tyre si dhe dhunën e terrorin e ushtrisë serbe në Kosovë gjatë kësaj kohe. Ai flet edhe për rrethanat e rritjes së numrit të hebrenjve në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore. Sipas regjistrimit të vitit 1921 vërtetohet se në qarkun e Kosovës gjendeshin gjithsej 506 banorë hebrenj. Bajraktari më tej vlerëson se “serbët goditën rëndë hebrenjtë e Kosovës” e këtë e mbështet duke bërë krahasimin e dhunës së ushtruar ndaj popullsisë shqiptare dhe asaj hebreje në Kosovë.

Autori ndalet në përbuzjen dhe fyerjet që politika serbe dhe jugosllave në Mbretërinë SKS iu bënte hebrenjve. Këtë e ilustron me faktin se në një shkrim të Vladan Gjorgjeviçit, ish kryeministër i Serbisë thuhej: “shqiptarët mund të krahasohen me hebrenjtë të cilët deri vonë kishin pasur bishta si majmunët”. Gjendja e komunitetit hebre filloi të përkeqësohej kur qeveria e Mbretërisë jugosllave më 13 qershor 1936 nxori një ligj i cili ua ndalonte të gjithë banorëve jo serbë të Kosovës ndërrimin e vendbanimeve dhe lëvizjen e lirë. Për dallim nga kjo pozitë hebrenjtë në shtetin e pavarur shqiptar të kësaj periudhe ishin plotësisht të integruar dhe gëzonin të gjitha të drejtat. Këtë e ilustron me faktin se “Pjesëtarët e komuniteti hebraik kanë qenë të përfshirë aktivisht në jetën shoqërore, madje edhe patriotike, që zhvillohej në Shqipëri”.

Kaptinë e veçantë e këtij libri është qëndrimi dashamirës dhe sakrificë e shqiptarëve në mbrojtje të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Çështja hebraike brenda territorit shqiptar vjen duke u bërë gjithnjë e më komplekse si rezultat i zhvillimeve politike ndërkom-bëtare që rezultuan me pushtimin e Shqipërisë e pastaj edhe të Jugosllavisë. Zhvillimet dramatike e rrisin numrin e banorëve hebrenj brenda Mbretërisë Shqiptare, por gjithashtu e kufizojnë atë në Kosovë sidomos në zonat pushtuese gjermane e bullgare. Shqipëria bëhet e vetmja derë shpëtimi për hebrenjtë, andaj edhe kufiri i saj do të vërshohej nga refug-

jatët hebrej. Në mëngjesin e 29 korrikut të vitit 1941 arrin në Durrës grupi i parë prej disa dhjetëra familjeve nga Kotorri. Ata vinin nga zona të ndryshme të Jugosllavisë si nga Beogradi, Sarajeva, Zagrebi etj. Ardhjet ishin të vazhdueshme. Vetëm disa ditë më vonë do të niseshin në drejtim të Shqipërisë 200 deri në 300 hebrej të Spaltës. Ndërkaq, në muajin shtator erdhën në tokën shqiptare edhe 350 hebrej nga Mal të Zi dhe u vendosën në Kavajë.

Me ardhjen e trupave gjermane në Shqipëri fillon pasiguria dhe frika tek komuniteti hebraik vendës dhe tek të ardhurit e shumtë. Kjo i shtyri ata që të zhvendoseshin në drejtime të ndryshme, brenda vendit, ku gjetën mikpritjen tradicionale shqiptare. Një nga refugjatët e shumtë hebrej, Samuilo Mandil, i përkujton kështu ato ditë: “Kje ni panik i vërtet për këta njerëz të shumë-vuejtun, sepse e dijsim se ç’bisha t’egra ishin tue ardhë në Shqipni. Ndër këto çaste të vështira populli shqiptar e tregoj shpirt-madhësinë e tij të vërtetë. ..i mëshefi ndër fshate të largëta, ku gjermanët nuk muejshin me shkue dhe fshatartë e vorfën, kur ndigjuen se kishin ardhë njerëz të pafajshëm të ndjekun nga bishat hitleriane, e ndan me ta edhe kafshatën e tyne të fundit”. Ky citat autentik i njërit nga njerëzit që kishte përjetuar traumat e ndjekjes së hebrejve është dëshmia më e mirë për trajtimin e hebrejve nga ana e shqiptarëve. Qëndrimi i Shqipërisë komuniste ndaj hebrejve ishte korrekt për vet faktin se ishte i vetmi vend në Evropë me më së shumti hebrej në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Autori Haxhi Bajraktari ven në pah edhe trajtimin e periudhës së tranzicionit në Shqipëri, çështjen e Kosovës dhe qëndrimin hebraik (1991-2008) duke e nisur me një fotografi të ish-kongresmenit amerikan Tom Lantosh i cili ishte një ndër personalitetet më të njohura që kishte përkrahur çështjen e Kosovës dhe shqiptarët në përgjithësi në Kongres, në institucione tjera amerikane dhe në takime e vende të ndryshme në botë. Autori çmon dhe vlerëson shumë përkrahjen e dhënë çështjes së Kosovës nga komuniteti hebraik në SHBA. Ai ofron fakte të rëndësishme edhe për mikpritjen e shqiptarëve të Kosovës në Izrael në ditët më të vështira për Kosovën dhe popullin e saj që i kanosej shfarosja fizike, pikërisht sikur hebrejve në kohën e Luftës së Dytë Botërore. Haxhi Bajraktari me kompetencë analizon marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me Izraelin dhe krijimin e Shoqatës së miqësisë shqiptaro-izraelite të quajtur “Shoqata e Miqësisë Izrael-Shqipëri”. Propaganda

serbe dhe e vërteta “Kosova – Jerusalemi serb” është kapitulli i fundit të cilin autori e fillon me pamjen e pullave postare serbe të cilat përmbajnë elementë antisemitizmi. Më tej vazhdon me krahasimin e rremë serb, me parullën “Kosova – Jerusalemi serb”. Krijimi i mitit serb të Kosovës thotë Bajraktari, ka shkuar aq larg në vetëdijen e shumë prej serbëve sa që rëndësia e tij është vënë në paralelizmin e saj me rëndësinë e Jerusalemit për kombin hebraik.

Tezat serbe autori i hedh poshtë me fakte dhe pamje autentike të depërtimit masiv të hebrenjve nga Serbia. Mllef i antisemit, buron nga besimi në “Konspiracionin botëror hebraik”, viktimë e të cilit, sipas tyre, është padyshim Serbia. Këto fakte e të dhëna besoj se e ilustrojnë më së miri qëndrimin kundër hebrenjve në një pjesë të shoqërisë serbe në të kaluarën dhe këtë aktuale përfundon me të drejtë autori Haxhi Bajraktari.

Autori i këtij libri ka hulumtuar materiale arkivore në Arkivin Qendror të Shqipërisë, në Arkivat Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Arkivin e Qytetit të Prishtinës, në Arkivin Amerikan Hebraik në New York dhe në Arkivin Amerikan Hebraik në Ohio.

Në fund dua të theksoj se Monografia “Marrëdhëniet Shqiptaro-Hebraike” e autorit Haxhi Bajraktari e hartuar mbi të dhënat e burimeve relevante historike, në bazë të cilave janë nxjerrë përfundime të qëndrueshme do të shërbejë si një model i mirë për studiuesit e mëvonshëm që do të merren me marrëdhëniet shqiptaro-hebraike. Le të jetë kjo një nismë e mbarë për autorin Haxhi Bajraktari dhe studimet e ardhshme në këtë fushë.